

Manuali Aktiv i Auditimit IT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 1329 prot.

Tiranë, më 27/11/2018

VENDIM

NR. 171, Datë 27/11/2018

**PËR MIRATIMIN E MANUALIT AKTIV TË AUDITIMIT TË TEKNOLOGJISË SË
INFORMACIONIT**

Bazuar në Ligjin 154/2016, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të objektivave të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH 2018 – 2022, dhe në zbatim të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t,

VENDOSA:

1. Miratimin e “Manualit Aktiv të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit”.
2. Manuali Aktiv i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit është një mjet hartuar gjatë projektit të Binjakëzimit mes SAI-ve të Polonisë dhe Kroacisë dhe mbështetet në Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit për Institucionet Supreme të Auditimit, botim i Grupit të Punës së INTOSAI-t për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit (WGITA). Ai përfaqëson analizën dhe praktikën më të mira të SAI-ve të vendeve anëtare të INTOSAI-t dhe BE-së dhe pas miratimit bëhet pjesë e kuadrit rregullator dhe procedural për kryerjen e auditimeve të Teknologjisë së Informacionit në KLSH.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Bujar LESKAJ



Udhëzues mbi Manualin Aktiv të Auditimit IT

1. Hyrje

“Auditimi i IT është ekzaminimi i implementimit të sistemeve IT për të siguruar përmbushjen e nevojave të organizatës pa kompromentuar sigurinë, privatësinë, koston dhe elementet e tjera kritike të biznesit.”

(WGITA – IDI “DORACAKU MBI AUDITIMIN E IT-SË PER INSTITUCIONET SUPREME TË AUDITIMIT”)

“Auditimi i IT-së është, pra, një term i gjerë që përshkon Auditimet Financiare (për të vlerësuar korrektësinë dhe pajtueshmërinë me pohimet e tjera të pasqyrave financiare të një organizate), Auditimet e Përputhshmërisë (vlerësimi i kontrolleve të brendshme) dhe Auditimet e Performancës (për të vlerësuar nëse sistemet e IT përmbushin nevojat e përdoruesve dhe nuk e vënë subjektin përballë riskut të panevojshëm.

(ISSAI 5300 PARAGRAFI 3.2)

Mjeti “Manuali Aktiv i Auditimit IT” ka si objektiv kryesor vendosjen në praktikë të “Manualit WGITA - IDI mbi Auditimin e IT-së për Institucionet Supreme të Auditimit”, duke ndihmuar audituesin me informacione thelbësore për të planifikuar një auditim të IT-së, mbledhjen e gjetjeve dhe shkëmbimin e njohurive.

Ai ofrohet si një zip folder. Ai përmban fletë pune Excel dhe disa dokumente Word, si dhe dokumente html që veprojnë si burime të të dhënave për Excel spreadsheet. Pasi të depaketohen, të gjithë skedarët duhet të mbahen në të njëjtën dosje dhe nën-dosje.”

Sjellja e brendshme e spreadsheet të Excel si dhe të disa dokumenteve të Word janë përshtatur/hedhur në VBA. Për të ndihmuar në inspektimin e kodit është komentuar e gjitha në Anglisht. Ajo referon vetëm funksionet dhe objektet të pre-instaluar në OS (nuk ka nevojë të referohen “librari” shtesë). Kështu duhet vetëm të aktivizohen macros!

Disa nga dokumentat Word përmbajnë kontrolle të përmbajtjes që duhet të ruhen dhe të përdoren për të futur të dhënat e kërkuara. Automatizimet varen prej tyre.

Dokumentat html janë mbajtur të të dhënave për SVG (Scalable Vector Graphics), në përputhje me standartet W3C për të shënuar grafikë. Në ditët e sotme SVG implementohet në Firefox, Opera, Safari, Chrome, Edge, Internet Explorer dhe në shfletues të tjerë. Shfletuesit web duhet të mbahen të përditësuar.

Dokumentat ishin testuar në versionet 2007/2010, 2013 dhe 2016 të Microsoft Office.

Udhëzues mbi Manualin Aktiv të Auditimit IT

Konsideroni këtë mjet jo si një produkt të përfunduar, por si një prototip. Ai ndjek nga afër qasjen e përcaktuar në WGITA - IDI Manual mbi Auditimin e IT-së për Institucionet Supreme të Auditimit.

Qëllimi kryesor është që t'u ofrojë përdoruesve udhëzime praktike, informacione thelbësore teknike dhe pyetje kyçe të auditimit të nevojshme për planifikimin dhe kryerjen e auditimit efektiv të IT.

Diagrama e plotë e procesit është si më poshtë:



Është e rëndësishme të sigurohet që procesi i auditimit të ruhet për të mundësuar verifikimin pasues, monitorimin dhe pjesëmarrjen e procedurave të analizës së auditimit (ISSAI 100 PARAGRAFI 42). Kjo përfshin dokumentimin e:

- Planit, fushëveprimit dhe objektivave,
- Programit të auditimit,
- Evidencave të mbledhura

Është hartuar një plan aktiviteti i modelit, i cili përfshin lëndën, kriteret dhe fushëveprimin, si dhe matricat e auditimit për të ndihmuar në regjistrimin e gjetjeve gjatë punës së auditimit IT. Këto matrica aktualisht merren nga anekset e WGITA IDI Doracaku mbi Auditimin e IT në Institucionet Supreme të Auditimit dhe mund të përdoren nga audituesit si letra pune. Rezultatet e fituara mund të mblidhen së fundi në një pikë qendrore për të ndihmuar audituesin të interpretojë dhe gjykojë pyetjet e auditimit të ngritura më parë në fazën e planifikimit. Ato gjithashtu formojnë thelbin e informacionit për të ndarë me komunitetin, së bashku me referencat për raportin e publikuar të auditimit, në projektin "Control Space of e-Government" (CUBE), një Iniciativë e EUROSAI.


Udhëzues mbi Manualin Aktiv të Auditimit IT

Aktivitetet paraprake dhe parakushtet për zhvillimin e auditimit

“Audituesit duhet të kenë njohuri të përgjithshme të natyrës së subjektit dhe programit që do të auditohet”.
(ISSAI 100 PARAGRAFI 49)

Brenda dosjes "ActiveITAuditManual" ju do të gjeni një spreadsheet Excel të quajtur "StartHere.xlsm" (mbani mend, ju duhet të keni të aktivizuar makro!). Filloni me të.

Në faqen/tabelën e parë të punës (me titull "**Audit Description**") audituesit mund ta përshkruajnë auditimin në mënyrë më të detajuar, ta rregullojnë atë, duke përdorur plugin-et e disponueshme (të mbuluara më thellësisht në **seksionin 6.**) dhe të planifikojnë vetë procesin duke analizuar fushat dhe çështjet potenciale duke identifikuar mirë risqet dhe problemet



Pjesa e poshtme e fletës së punës i siguron përdoruesit udhëzime shtesë (siç është theksuar në ISSAI 5300):

- Roli dhe koha e planifikimit;
- Aktivitetet paraprake të angazhimit;
- Aktivitetet e planifikimit;
- Njohjen e të audituarit dhe të mjedisit;
- Fushëveprimi i vlerësimit: Cilat sisteme informacioni, cilat kufij logjik, fizik apo gjeografik?
- Burimet në dispozicion: Stafi i kualifikuar ose konsulentët, buxhetet, afatet kohore;
- Disponueshmëria e statistikave të besueshme të kërcënimeve dhe shifrave të kostos, të përshtatshme për kushtet lokale; përshtatjen e vlerave të paracaktuara, sipas nevojës;

Udhëzues mbi Manualin Aktiv të Auditimit IT

- Çështje shtesë në angazhimet fillestare të auditimit.

Preliminary activities and start of planning	
	A1 Preliminary Activities
	01 Preliminary activities
	02 Planning meeting of the IT audit team
	03 Opening meeting with the management of the audited entity
	A2 Planning the Audit
	01 Understanding the entity
	02 Understanding the IT-systems
	03 Input into audit strategy and audit plan

Këto aktivitete janë të shpërndara në fusha (domaine). Ato janë një hyperlink për matricën korresponduese, e cila do të ndihmojë audituesin.

Working Paper

SAI IDENTIFICATION	Record:	
	Area:	
	Ref.:	
	Index:	
Audit/Entity:		
Performed by	Date	Reviewed by
Click here to enter text.	dd.mm.yyyy	Click here to enter text.
Subject: Preliminary activities		

:

Do the staff assigned to this IT-audit have sufficient competence and required capabilities?
Criteria: ISSAI 5300.8 and 16. - The IT audit team is composed of members that collectively have the competence to perform the IT Audit.
Description:

Në veçanti, matrica e quajtur 02 Understanding the IT Systems, nën aktivitetet paraprake të fushës A2, gjithashtu është e automatizuar. Ajo harton fusha (domaine) të ndryshme të IT për të ndihmuar audituesin të kryejë një vlerësim paraprak të Kontrollit të IT-së, siç thuhet në ISSAI 5300 21.1. Pasi të përdoret dhe të mbushet, mund të sinkronizohet më vonë me analizën e riskut si një sugjerim dhe një udhëzues për gjykimin e audituesit.

Analiza e para-auditimit

Qëllimi i analizës së para-auditimit është të sigurojë të dhëna, të cilat do të mbështesin analizën e riskut, për shembull bazën për planifikimin e auditimit dhe organizimin e dosjes fillestare të auditimit. Procesi është si më poshtë:

Udhëzues mbi Manualin Aktiv të Auditimit IT

Input

- Informacionet e marra nga të audituarit në fazën e para-auditimit;
- Të dhëna shtesë të rëndësishme në lidhje me të audituarin dhe sistemet e tyre të IT;
- rezultatet e auditimeve të tjera tek i audituari ose mbulimin e llojeve të ngjashme të problemeve .

Hapat:

1. Analizoni të dhënat e disponueshme.
2. Gjeneroni formën *A2.02 Understanding the IT Systems* – kjo do të varet nga tipi i auditimit IT që ju kryeni – i bazuar në Doracakun Standard të Auditimit IT ose I bazuar në *Plugin*. Forma do të gjenerohet automatikisht pas klikimit të *A2.02 Understanding the IT Systems*, dhe do të marrë parasysh bazat e *Auditimit IT*.
3. Vendosni për kualifikimet e fushave përkatëse në formën *A2.02 Understanding the IT Systems*.

Preliminary Assessment of IT Controls (ISSAI 5300-21.1)	
Suitable mechanisms are in place and functioning	
Ensure IT Governance:	
Please, link here the auditee answer(s)...	
Responsibilities defined: High	
Adequate structure: High	
Sufficient regulation: High	
Explanatory and clear documentation: Medium	
Business Needs Identification, Direction and Monitoring: Medium	
IT Strategy and Planning: Low	
Organisational structures, Standards, Policies and Procedures: High	
People and Resources: High	
Risk Assessment and Compliance mechanisms: High	
<hr/>	
Ensure IT Operations:	
Please, link here the auditee answer(s)...	
Responsibilities defined: Medium	
Adequate structure: High	
Sufficient regulation: Low	

4. Vendosni rezultatet e analizës të para-auditimit në formën e analizës së riskut. Për këtë hap përdoruesi duhet, së pari, të aksesojë worksheet-in “Plan” dhe të shtypi butonin veprues “Get Areas and Issues” për të marrë informacion për fusha të ndryshme të IT të cilat do të asistojnë audituesit IT në identifikimin e fushave potencialisht të auditueshme. Në fund të listës gjendet një buton i ri, i quajtur “Sync Pre-Assessment”. Pasi shtypet ky buton, starton procesin e sinkronizimit ndërmjet informacionit të mbledhur më parë dhe të vlerësuar në para-vlerësim dhe në



Udhëzues mbi Manualin Aktiv të Auditimit IT

analizën e riskut.

	Area	Issue	Risks (Weight)	Include in Audit	Reasons, risks and remarks
IT Governance	01 Business Needs Identification, Direction and Monitoring	01 Defining IT requirements	2 - Medium	<input checked="" type="checkbox"/>	Pre-Assessment: Domain - High, Area - Medium;
		02 Leadership	2 - Medium	<input checked="" type="checkbox"/>	Pre-Assessment: Domain - High, Area - Medium;
	02 IT Strategy and Planning	03 IT investments	2 - Medium	<input checked="" type="checkbox"/>	Pre-Assessment: Domain - High, Area - Medium;
		01 Quality of IT strategy	1 - Low	<input checked="" type="checkbox"/>	Pre-Assessment: Domain - High, Area - Low;
		02 Risk management	1 - Low	<input checked="" type="checkbox"/>	Pre-Assessment: Domain - High, Area - Low;
03 Organisational structures, Standards, Policies and Procedures	01 Structure of the IT Organization	3 - High	<input checked="" type="checkbox"/>	Pre-Assessment: Domain - High;	
	02 Policy and procedures	3 - High	<input checked="" type="checkbox"/>	Pre-Assessment: Domain - High;	
04 People and Resources	01 HR and logistics	3 - High	<input checked="" type="checkbox"/>	Pre-Assessment: Domain - High;	
05 Risk Assessment and Compliance mechanisms	01 Mechanism	3 - High	<input checked="" type="checkbox"/>	Pre-Assessment: Domain - High;	
	02 Key parameters	1 - Low	<input type="checkbox"/>		
06 IT Service Continuity management	01 Compliance	1 - Low	<input type="checkbox"/>		
	02 Effectiveness	1 - Low	<input type="checkbox"/>		

- Kompletoni analizën e riskut duke aplikuar një gjykim profesional duke marrë kështu dosje të reja auditimi.

Analiza para-auditimit mund të jetë e dobishme në pregatitjen e auditimit dhe në një analizë risku më precize. Ky mjet do të funksionjë, sidoqoftë, edhe nëse analiza nuk kryhet, gjë e cila nënkupton se analiza e riskut është e bazur vetëm në gjykimin profesional.

2. Plani për një zgjedhje të bazuar në vlerësimin e riskut (fushat, çështjet dhe dizenjimi i auditimit)

PËRZGJEDHJA E ÇËSHTJEVE

"Përcaktimi i Auditimit IT do të përfshijë vendosjen e shkallës së shqyrtimit të auditimit, mbulimin e sistemeve të IT dhe funksioneve të tyre, proceset e IT që do të auditohen, vendodhjet e sistemeve të TI që duhet të mbulojnë dhe periudhën kohore që duhet mbuluar"

(WGITA – IDI "DORACAKU MBI AUDITIMIN E IT-SË PER INSTITUCIONET SUPREME TË AUDITIMIT")


Audituesit duhet të zgjedhin fushat dhe çështjet e auditimit përmes procesit të planifikimit duke analizuar fushat dhe çështjet potenciale, si dhe identifikimin e risqeve dhe problemeve. Sapo të hapni faqen e punës së Excel "StartHere.xlsx" do të gjeni një fletë pune të quajtur "Plan". Ajo përcakton tabelën e fushave të ndryshme të IT të cilat do të ndihmojnë audituesit e IT-së në identifikimin e zonave potenciale të auditueshme.

18			
19			
20			
21			
22			

← → Plan +

Udhëzues mbi Manualin Aktiv të Auditimit IT

Shtypni butonin “Get Areas and Issues” për të marrë informacion. Në këtë fazë, audituesit duhet të përcaktojnë se cilat fusha dhe çështje janë të rëndësishme, dhe gjithashtu të auditueshme brenda kompetencave të SAI-t.



Ky buton përdoret për nxjerrjen e informacionit nga nën-dosjet dhe dokumentet. Pra, çdo modifikim i kryer nga SAI-të në përputhje me standardet e tyre do të pasqyrohet në tabelë.

Domain	Area	Issue	Weight	Include in Audit	Remarks
01 IT Governance	01 Business Needs Identification, Direction and Monitoring	01 Defining IT requirements	1 - Low	<input type="checkbox"/>	
		02 Leadership	1 - Low	<input type="checkbox"/>	
		03 IT Investments	1 - Low	<input type="checkbox"/>	
	02 IT Strategy and Planning	01 Quality of IT strategy	1 - Low	<input type="checkbox"/>	
		02 Risk management	1 - Low	<input type="checkbox"/>	
	03 Organizational Structures, Standards, Policies and Procedures	01 Structure of the IT Organization	1 - Low	<input type="checkbox"/>	

Siç mund të vihet re, është marrë tabela me fusha të ndryshme IT dhe me zonat e çështjet respektive.

Emri i vetë fushës është në vetvete një hyperlink në html, i cili ofron një përshkrim grafik (mind map diagram) të fushës së zgjedhur. Udhëzimet e dhëna në çdo fushë mund të ndihmojnë audituesit të planifikojë auditimet e tyre.

Në këtë tabelë përdoruesi fillon të shënojë (të përfshijë në auditim) dhe të përcaktojë çështjet e përshtatshme (peshën) për fokusin e përzgjedhur të auditimit.

01 Defining IT requirements	2 - Medium	<input checked="" type="checkbox"/>
02 Leadership	1 - Low	<input type="checkbox"/>
03 IT Investments	3 - High	<input type="checkbox"/>
01 Key parameters	3 - High	<input checked="" type="checkbox"/>
02 Compliance	3 - High	<input checked="" type="checkbox"/>
03 Effectiveness	1 - Low	<input type="checkbox"/>

Shënim: një rezultat i lartë (3) shënon automatikisht çështjen.

Ne e quajmë atë studim përmes kaskadës së fushës së IT: Identifikoni një fushë specifike ose një kombinim të fushave, fushat dhe çështjet më kritike, bazuar në fushëveprimin dhe


Udhëzues mbi Manualin Aktiv të Auditimit IT

objektivat e auditimit, në mënyrë që të mundësohet përdorimi efikas dhe efektiv i burimeve të kufizuara të auditimit.

Kjo përfshin:

"Të kuptuarit e kontrolleve të brendshme, si dhe objektivat, operacionet, mjedisi rregullator, sistemet dhe proceset e biznesit të përfshira. Çdo fushë e kontrollit bazohet në një sërë objektivash kontrolli që një organizatë vendos për të zbutur një risk kontrolli. Roli i audituesit është të kuptojë risqet potenciale të biznesit dhe IT me të cilat ballafaqohet subjekti i audituar dhe pastaj të vlerësojë nëse kontrollet e vendosura janë adekuate për të përmbushur objektivin e kontrollit "

(WGITA – IDI “DORACAKU MBI AUDITIMIN E IT-SË PER INSTITUCIONET SUPREME TË AUDITIMIT)



Në këtë nivel, është arritur:


- Rëndësia relative e çështjes së shënuar të IT-së lidhur me fushën dhe zonën që lidhet me IT-në (mbani në mend kaskadën e fushës); dhe

Udhëzues mbi Manualin Aktiv të Auditimit IT

- Rëndësia përfundimtare e çështjeve që lidhen me IT (një koleksion i rëndësisë relative që duhet të pasqyrojë në fund objektivin, fushëveprimin dhe përgjigjet në pyetjet e auditimit).

Teknika formale, të tilla si analiza e riskut ose vlerësimi i problemeve, burimet e mundshme të provave, auditueshmëria dhe rëndësia e çështjes që merret në konsideratë, që mund të ndihmojnë procesin e planifikimit mund të regjistrohen në kolonën e shënimeve. Më vonë, audituesi do të marrë më shumë ndihmë përmes matricave të auditimit.

Ideja kryesore është të ndihmojë audituesin të fitojë njohuri të mjaftueshme për objektivin dhe fushëveprimin e auditimit, të diskutojë dhe plotësojë atë, duke siguruar kështu një plan të duhur. Në çdo kohë, audituesi mund të pastrojë gridën dhe ta rifillojë të gjithë procesin duke shtypur butonin e veprimit "Reset Data".



Përdoruesi duhet të analizojë rezultatin dhe të përshtasë kur është e nevojshme.


Pastaj, ai duhet të zgjedhë butonin e veprimit "Generate Audit" (i vendosur në fund të listës) për të kaluar në hapin e ardhshëm:

- Krijimi i strukturës së të dhënave specifike të auditimit të IT, i populluar me fushat e shënuara dhe çështjet;
- Lidhur me dokumentet e punës dhe matricat që mbështesin përkufizimin e procedurave adekuate të vlerësimit; dhe
- Matricat.

Udhëzues mbi Manualin Aktiv të Auditimit IT

Protected	1 - Low	<input type="checkbox"/>	
			Generate Audit







Sistemi do të nxisë përdoruesin për një referencë ose një emër të shkurtër të kontrollit të IT. Kjo do të përdoret për të krijuar dosjen kryesore në path-in e përzgjedhur. Për të minimizuar problemet e menaxhimit të skedarëve në të ardhmen, mbani emrin ose referencën e auditimit nën 20 shkronja dhe pa shenja të veçanta si |, /, "" ose #)! ".



Pasi të shtypni butonin e veprimit "Generate Audit" dhe fusni referencën, mjeti do të:

- Ndërtojë strukturën e dosjeve me prefiksin "Auditimi IT" + <reference> në rrënjë;
- Kopjojë informacionin specifik në lidhje me zonat e shënuara dhe çështjet e IT (si dhe materialet ndihmëse dhe mbështetëse);
- Ndryshojë emrin e spreadsheet-it të Excel "StartHere.xlsx" në prefiksin "Monitor" + <reference> Brenda dosjes rrënjë.

Ju mund të vini re në imazhin e mëposhtëm shembullin e një auditimi të gjeneruar me këtë mjet, i cili përmban vetëm tre fusha dhe faqen e punës tashmë me emrin e ri.

-  02 IT Operations
-  03 Development and Acquisition
-  04 Outsourcing
-  Help
-  Support Templates
-  MonitorElectronic Passport.xlsx

Udhëzues mbi Manualin Aktiv të Auditimit IT

DIZENJIMI I AUDITIMIT

"Mikro-planifikimi përfshin zhvillimin e një plani të detajuar të auditimit për auditimin e subjektit të zgjedhur duke filluar me përvijimin e objektivave të auditimit" ... "Planifikimi i nivelit mikro kërkon një kuptim të organizatës dhe disa vlerësime paraprake të kontroleve për të lehtësuar planifikimin e hollësishëm të auditimit.


(WGITA – IDI “Doracaku mbi Auditimin e IT-së per Institucionet Supreme të Auditimit)

"Audituesit duhet të planifikojnë auditimin në një mënyrë që kontribuon në një auditim me cilësi të lartë që do të kryhet në mënyrë ekonomike, efikase, efektive dhe në kohë dhe në përputhje me parimet e menaxhimit të mirë të projektit".

(ISSAI 300 PARAGRAFI 37)


Fleta e punës "Monitor" + <referenca>, brenda dosjes rrënjë të auditimit, tani e mbrapa paraqet një strukturë tjetër:

- Butonat e rinj veprues shfaqen në fletën e punës "Plan" për të ndihmuar audituesin të përgatisë programet e hollësishme të auditimit;
- Tabela me fushat e ndryshme të IT dhe me zonat e çështjet respektive vetëm prezantojnë vetëm ato çka janë shënuar në fazën paraardhëse, si dhe peshat përkatëse;



Domain	Area	Issue	Weight	Include in Doc.	Remarks
02 IT Operations	02 IT Service Continuity management	01 Key parameters	3 - High	<input type="checkbox"/>	
		02 Compliance	3 - High	<input type="checkbox"/>	
03 Development and	02 Project Management and Control	02 Control IT projects	2 - Medium	<input type="checkbox"/>	
	04 Subscribers	01 Plan or procedure of solicitation acts	3 - High	<input type="checkbox"/>	
04 Outsourcing	01 Outsourcing Policy	01 Policy on outsourcing	3 - High	<input type="checkbox"/>	
	01 Vendor or Contract Management	01 Vendor or Contractor Monitoring	2 - Medium	<input type="checkbox"/>	
	02 Back Up and Disaster Recovery for electronic services	01 Back up and disaster recovery for out	3 - High	<input type="checkbox"/>	

- Tre fletë pune të reja gjenerohen, duke mbuluar analizat bazë statistikore, dhe hapat e ndryshëm të procesit të auditimit.



Duke u fokusuar në tabelë, çështjet IT janë tashmë një hyperlink për matricën koresponduese, e cila do të ndihmojë audituesin si një pikënisje për të vlerësuar kontrollet që organizata ka përdorur për të menaxhuar dhe zbutur në një nivel të pranueshëm riskun me të cilin ajo përballet në këtë fushë/domain.

Udhëzues mbi Manualin Aktiv të Auditimit IT

Për më shumë informacion, ju lutemi shikoni Aneksin 1 të (WGITA – IDI “Doracaku mbi Auditimin e IT-së për Institucionet Supreme të Auditimit) (fq. 22-23).

Përdorimi i matricës së auditimit, gjenerimi programeve të auditimit

Formati tipik për matricën e auditimit mundësuar nga ky mjet, siç përcaktohet nga (WGITA – IDI “Doracaku mbi Auditimin e IT-së për Institucionet Supreme të Auditimit), është si më poshtë:

AUDITABLE AREA	
Audit objective:	
AUDIT Issue:	
Criteria:	
Information Required	Analysis Method(s)
Audit Conclusion	
To be filled in by auditor:	

Matricat e sugjeruara të auditimit mbulojnë procesin e auditimit të IT. Ato përshkruajnë çështje të rëndësishme të Auditimit, kritere, metoda të analizave në fusha të ndryshme të auditimit të TI-së.

Matricat duhet të përgatiten në fazën e planifikimit, megjithatë përmbajtja mund të përditësohet gjatë procesit të auditimit IT, nëse është e nevojshme.

Këshilla, shembuj dhe praktikat më të mira janë të shënuara në gri për të drejtuar audituesin. Ato mund dhe duhet të zëvendësohen / shtrihen me informacionin e duhur për auditimin e caktuar:

Udhëzues mbi Manualin Aktiv të Auditimit IT

Analysis Method(s)

....

Check whether data backup and recovery practices are consistent with the entity's BCP standards.

Check if the Business Process Owners have signed on the agreement. Interview sample of users to understand the awareness.

....

Matricat e auditimit janë dokumenta MS Word (format .docx). Kolonat e tyre të brendshme përmbajnë "Kontrollet e përmbajtjes" që veprojnë si tregues për të gjeneruar programet e auditimit. Pra, audituesi ka mundësinë të zëvendësojë informacionin në zonat gri me atë të duhur, duke e shtrirë atë nëse është e nevojshme dhe / ose duke ndryshuar formatet dhe stilet e tekstit, por **duhet të ruajë kontrollet e përmbajtjes (automatizimi i ardhshëm varet prej tyre).**

Duke plotësuar kërkesat ISSAI lidhur me fazën e planifikimit të procesit të auditimit, ky mjet gjeneron programet e auditimit, të populluara me të dhënat e regjistruara më parë në matricat e auditimit dhe siguron që ato të ruhen në kontejnerë standardë për të mundësuar verifikimin pasues të procedurave të analizës së auditimit.


Audituesi duhet të shënojë çështjen që ai kërkon të përfshijë si pjesë e dokumentacionit në 'checkbox-et' përkatës.

(mark the issue that you want to make part of the documentation in the col


Issue	Weight	Include in Doc.	
01 Key parameters	3 - High	<input checked="" type="checkbox"/>	
02 Compliance	3 - High	<input checked="" type="checkbox"/>	
02 Control IT projects	2 - Medium	<input checked="" type="checkbox"/>	
01 Plan or procedure of solicitation activ	3 - High	<input type="checkbox"/>	
01 Policy on outsourcing	3 - High	<input type="checkbox"/>	

Aktualisht, dy dokumente janë të ofruar, program i auditimit dhe memo, të dyja të gjeneruara nga audituesi duke klikuar butonin veprues përkatës:

Udhëzues mbi Manualin Aktiv të Auditimit IT



Ata duhet të ruhen në një nën-folder të ri, të quajtur "Mandatory Documents", nën dosjen rrënjësore të auditimit (prefiksin "IT Audit" + <referenca>).



Përveç faktit se programi i auditimit dhe memo janë prodhuar në fazën e planifikimit të auditimit, ato përfshijnë veçori të ndryshme. Në fakt, memo është më shteruese sesa programi i auditimit.


Compare audit programme with memo

Feature	Audit Programme	Memo
Audit objective	●	●
Audit Issue	●	●
Criteria	●	●
Information Required	●	●
Analysis Method(s)	●	●
Audit Conclusion		●

Metrika

Duke përdorur veçoritë analitike dhe grafike të MS Excel, ky mjet siguron audituesin me një gamë të thjeshtë të të dhënave ("Metrics"), duke përfshirë vlerësimin e rëndësisë së domain-it.

Udhëzues mbi Manualin Aktiv të Auditimit IT



Përsëri, audituesi duhet të marrë në konsideratë pjesën e analizës së fletës së punës si pikë fillestare. Ne inkurajojmë të zhvillojmë raporte të reja dhe më të përshtatshme në përgjigje të SAI ose nevojave specifike të auditimit

3. Zhvillimi (mblidhni dhe konsolidoni gjetjet)

EVIDENCAT, GJETJET DHE KONKLUZIONET

"Audituesit duhet të marrin evidenca të mjaftueshme të auditimit për të vendosur gjetjet, pwr tw arritur konkluzione në përgjigje të objektivave të auditimit dhe të pyetjeve dhe të nxjerrin rekomandime."

(ISSAI 300 PARAGRAFI 38)

Mblidhni gjetjet

Për të ndihmuar audituesin që të mbledhë evidenca dhe konkluzione të përshtatshme që rrjedhin nga vlerësimi, mjeti ofron një matricë me strukturën e mëposhtme:

Finding	
Description	Start writing here
Legal Act	Start writing here
Paragraph	Start writing here
Domain	Select an Item
Area	Select an Item
Issue	Select an Item
Name the Cause	Start writing here
Name the Result	Start writing here
Reference to the report	Start writing here
Impact	Select an Item Select an Item Select an Item
Management Functions	Select an Item Select an Item Select an Item
Process Control	Select an Item Select an Item Select an Item
Basic Conditions	Select an Item Select an Item Select an Item

Udhëzues mbi Manualin Aktiv të Auditimit IT

Ky dokument, një dokument i MS Word, është i disponueshëm përmes dokumentit të punës "Findings", butonit të veprimit " Create Findings Document". E njëjta logjikë zbatohet si në matricat e tjera të auditimit :


- Kolonat e tyre të brendshme përmbajnë kontrollet e përmbajtjes që veprojnë si tregues për të konsoliduar gjetjet qendrore;
- Audituesi ka mundësinë të zëvendësojë informacionin në zonat gri me atë të duhur, duke e zgjeruar atë nëse është e nevojshme dhe / ose duke ndryshuar formatet dhe stilet e tekstit, por **duhet të ruajë kontrollet e përmbajtjes**.

Nëse audituesi dëshiron të regjistrojë më shumë se një gjetje në një dokument, duhet vetëm të kopjojë dhe vendosw tabelën e plotë, ose mund të krijojë një dokument tjetër duke shtypur butonin e veprimit " Create Findings Document". Janë të lejuara edhe kopje të dokumenteve, pasi mjeti do të lexojë tabelën e brendshme dhe ID-të e kontrollit të aplikacionit.

Këto matrica duhet të ruhen në një nën-dosje të re, të quajtur " Mandatory Documents ", nën dosjen rrënjësore të auditimit (prefiksin "IT Audit" + <reference>).

Konsolidoni gjetjet

Tabela brenda fletës së punës "Findings" ka për qëllim mbledhjen në nivel qendror dhe konsolidimin e rezultateve të nxjerra nga vlerësimi.



Ajo popullohet me të dhënat e regjistruara më parë në matricat e gjetjeve kur audituesi shtyp butonin përkatës:




Tabela e gjetjeve lejon audituesin të kthehet sërish më vonë, të ndryshojë përmbajtjen, të vendosë shënime ose referenca.

Vini re, ndryshimet e bëra në përmbajtjen e tabelës nuk janë ri-shkruar automatikisht në matrica. Është e mundur të zgjerohet përmbajtja direkt, megjithatë audituesit janë të ftuar që të shtojnë gjetje të reja përmes matricave, pasi ato mbahen në kontejnerë standardë dhe mundësojnë verifikime pasuese të procedurave të analizës së auditimit, duke përbushur kërkesat e ISSAI.

4. Shpërndani (pregatisni që të bëni ta bëni të aksesueshëm në "Control Space of e-Government")

SHPËRNDARJA E RAPORTIT

"Audituesi i IT duhet të raportojë në gjetjet e tyre në kohën e duhur dhe duhet të jetë konstruktiv dhe i dobishëm për subjektin e audituar, si dhe me kuptim për aktorët e tjerë. Raporti mund të dorëzohet tek autoritetet përkatëse sipas mandatit të SAI dhe Auditimit IT. "

(WGITA – IDI "Doracaku mbi Auditimin e IT-së për Institucionet Supreme të Auditimit)

"Procesi i auditimit përfshin përgatitjen e një raporti për të komunikuar rezultatet e auditimit tek palët e interesit, përgjegjës të tjerë për qeverisjen dhe publikun e gjerë".

(ISSAI 100 PARAGRAFI 51)

Gjetjet përbëjnë thelbin e informacionit për të ndarë me komunitetin, së bashku me referencat për raportin e publikuar të auditimit, në projektin "Control Space of e-Government" (CUBE), një iniciativë e EUROSAI.

Projekti "Control Space for e-Government Audit"

Siç përcaktohet në faqen e ëeb-it të EUROSAI IT Working Group (<http://eurosai-it.org/>), projekti "Control Space for e-Government Audit" është një mjet (aktualisht e njohur si "The Cube") ka për qëllim lehtësimin e auditimeve mbi e-qeverisjen. Mjeti është duke u zhvilluar nga disa SAI të Grupit Punues së IT të EUROSAI. Ai ka për qëllim të jetë një databazë "inteligjente" e raporteve të auditimit të e-qeverisjes nga SAI të ndryshme, nga të cilat ju mund të qaseni lehtësisht jo vetëm në raportet e SAI-ve për auditimet e qeverisjes elektronike, por edhe artikuj, prezantime, metodologji, baza të dhënash dhe materiale të tjera.

Ideja nuk është vetëm mbledhja e burimeve interesante të informacionit, por edhe sigurimi i tyre së bashku me analizën bazë - për momentin ne klasifikojmë tema, funksionet e menaxhimit, rastet e riskut dhe qëllimet e projekteve. Shpresojmë që kjo do ta bëjë më të lehtë për të gjetur shpejt një informacion interesant. Kjo bazë të dhënash e dokumenteve

Udhëzues mbi Manualin Aktiv të Auditimit IT

është projektuar kryesisht për audituesit publikë që punojnë në fushën e e-qeverisjes, por gjithkush që është i interesuar në auditimin modern të IT-së është i mirëpritur.”

Udhëzues mbi Manualin Aktiv të Auditimit IT

Audituesit, ashtu si dhe qytetarët mund të aksesojnë “The Cube” përmes URL-se së mëposhtme:

<https://egov.nik.gov.pl/>

Gjenerimi i indeksit të dokumentit

Mjeti ofron mundësinë për të krijuar pa probleme dokumentin e indeksit që do të preket nga bazat e të dhënave të EUROSAI së bashku me raportin e publikuar të auditimit (ose të paktën URL-në e tij).

Në rubrikën "Knowledge Sharing", audituesi do të gjejë një formë të të dhënave që përqendron informatat e rëndësishme të nevojshme për rikthimin dhe karakterizimin e auditimit. Formulari është i strukturuar në katër fusha kryesore:


Basic SAI Information		
Organization	SAI Identification	Name of institution which report relates to
	Acronym (e.g. KLSH)	Acronym of the institution
	www site	Webpage of the institution
	Country	Choose country code from dropdown box (based on ISO-3166 alpha-2 standard)

Basic summary information in English		
Front page Report HEADLINE	In bold	First sentence/part of the headline
	Text	Headline of the report (like a newspaper lead) for the front page of the databases

Basic report information		
Report	Title	Title of the Report in English
	Short Description	Short description of the Report (what was the report main goals)
	Year	Year when the report was published
	Document's ID	Original identification number of the report
	Type	Type of the Report selected from dropdown box (e.g. Full Translation, Original, Presentation or Summary)
	Language	choose country code for language of the Report from dropdown box (based on ISO-639-1 standard)
	www URL	URL or hyperlink to original report file (source)
	File name	Name of the original report file

Basic Analysis	
Topic(s)	Select the name of the topic with which the report subject relates (maximum three)
State Activity Areas	Choose particular activity area with which the report subject relates

Pasi të jetë plotësuar, audituesi mund të krijojë dokumentin e indeksit duke shtypur butonin e veprimit "Generate XML (Cube)", që ndodhet në fund:



Një skedar XML i formuar mirë dhe i vlefshëm do të prodhohet, duke kombinuar të dhënat input dhe gjetjet, në nëndosjen "Dokumentet e detyrueshme" nën dosjen rrënjësore të auditimit (me prefiks "IT Audit" + <reference>).

5. Përdorimi i plugins

KONCEPT


Në Doracakun Aktiv të Auditimit IT, një plugin (ose plug-in, ose shtesë) është një komponent që shton një veçori specifike në Manualin "Standard" për Auditimin e IT-së për Institucionet Supreme të Auditimit. Ndërsa mjeti mbështet plugins-et, mundësohet përshtatja ose shtimi i veçorive të reja.

Shembujt e zakonshëm janë planet e aktiviteteve të modelit të prodhuara për auditime specifike të IT-së, që përfshin lëndën, kriteret dhe fushëveprimin e prodhuar, si dhe matricat e auditimit për të ndihmuar në regjistrimin e gjetjeve gjatë kryerjes së auditimit IT. Në këtë kuptim, një auditim i krijuar nga e para për një temë dhe fushë të caktuar, me matrica të parametrizuara në një mënyrë specifike, mund të ripërdoren më vonë nga mjeti si një plugin, duke lejuar kështu pjesën dhe ripërdorimin e njohurive.

Plugin-et mund të shihen në kontekstin e përgjithshëm të mjetit si më poshtë:

Udhëzues mbi Manualin Aktiv të Auditimit IT

Figure 1. Cosoistic view of IT-Audit in Government



Në të ardhmen, plugin-i do të përdoret për të shtuar funksione të reja dhe për të rinovuar Doracakun për Auditimin e TI-së për Institucionet Supreme të Auditimit (SAI), duke theksuar fushat e reja të interesit dhe duke u ofruar përdoruesve informata thelbësore dhe pyetje kyçe të nevojshme për një planifikim efektiv të auditimeve IT.

QËLLIMI DHE SHEMBUJ

Aplikacionet suportojnë shtojcat për shumë arsye. Disa nga arsyet kryesore përfshijnë:

- Të mundësojë SAI-të e palëve të treta për të krijuar aftësi që zgjerojnë ose përshtatin një aplikacion;
- Të mbështesë shtimin e thjeshtë të veçorive të reja;
- Të reduktojë madhësinë e një aplikacioni;
- Të promovojë praktikat dhe modelet më të mira në auditim, duke u fokusuar në tema të veçanta;
- Të shpërndajë dhe të ripërdorë njohuri midis audituesve të SAI ose midis SAI-eve;

Udhëzues mbi Manualin Aktiv të Auditimit IT

- Për të adresuar fusha të reja me interes për audituesit e IT-së, si cloud-computing, shërbimet e Ëebit ose iniciativat e të dhënave të hapura.

MEKANIZMI

Mjeti siguron shërbime që plugin mund të përdorë, duke përfshirë një mënyrë për plugin që të regjistrohen me mjetin dhe një strukturë të përcaktuar për shkëmbimin e të dhënave me plugin-e.

Një plugin ende varet nga shërbimi dhe strukturat e siguruara nga mjetet dhe zakonisht nuk punojnë vetë. Në anën tjetër, mjeti vepron në mënyrë të pavarur nga plugin-i, duke përdorur manualin "standard" mbi Auditimin e IT-së për Institucionet Supreme të Auditimit si bazë operacionale dhe informative, duke u mundësuar përdoruesve të fundit të shtojnë dhe përditësojnë plugin-et dinamike pa pasur nevojë të bëjnë ndryshime në mjetin mbajtës.


Doracaku Aktiv i Auditimit IT suporton dy lloje plugin-esh

- Plugin-et standarde, duke reflektuar strukturën kryesore të Doracakut;
- Plugin-e të pavarura dhe forma të lira, duke reflektuar vetëm strukturën e përgjithshme të Doracakut kryesor.

Megjithatë, duhet të ndiqen disa rregulla të thjeshta

- Vendosni përmbajtjen e plugin-it në një dosje kryesore ose rrënjë, të titulluar me një emër të shkurtër ose referencë.


Si opsion, rezervoni emrin e plotë dhe detajet tjera praktike të plugin-it për fushat "Titulli" dhe "Përshkrimi" në fletën "Audit Description", në dispozicion në faqen e punës Excel të titulluar "StartHere.xlsm".



Në këtë rast, përfshini gjithashtu tabelën në dosjen kryesore të plugin-it

Udhëzues mbi Manualin Aktiv të Auditimit IT

Një strukturë tipike e një plugin-i mund të shihet në imazhin e mëposhtëm (plugin "Open Data Strategy"):



Për të minimizuar problemet me menaxhimin e skedarëve në të ardhmen ju lutemi mbani emrin e plugin-it me më pak se 30 karaktere dhe pa karaktere speciale si psh. |, /, "" or #)!"

- Respektoni tabelën e përputhjes së fushave dhe çështjeve të ndryshme të IT (të lidhura me matricat) të cilat do të ndihmojnë audituesit e IT-së.

Mjeti mbështetet në një strukturë të dosjeve dhe nën-dosjeve që përcaktojnë fusha dhe zona, si dhe në dokumentet e skedarëve, brenda zonave të nën-kartelave, që prodhojnë çështjet dhe në të vërtetë janë matricat e auditimit.

Plugin-et e rinj duhet gjithmonë të përputhen me **dosjen e fushës > nëndosjen e fushës > skedarin e çështjes**.

Prandaj, gjeneroni një strukturë të dosjeve me tre nivele

- dosjen kryesore të titulluar me një emër të shkurtër të plugin-it;
 - nivelin e parë të dosjeve të plugin-it – duke pasqyruar fushat e kontrollit të IT siç janë përcaktuar nga Doracaku
 - nivelin e dytë të dosjeve dhe përmbajtjen e tyre (skedarët e matricave të auditimit) mund të pregatiten lehtësisht – duke ndjekur një logjikë të nevojave të veçanta të auditimit.
- Përgatitni një përshkrim të temës së plugin-it në një editor teksti.

Edhe pse nuk është një kërkesë e detyrueshme, është shumë e këshillueshme që të jepni një përshkrim të plugin-it, pasi kjo i siguron përdoruesit e plugin-it të kuptojnë kontekstin dhe objektivat.

Udhëzues mbi Manualin Aktiv të Auditimit IT


Përshkrimi i plugin duhet të përgatitet në një editor teksti dhe të ruhet me emrin "Përshkrimi i Auditimit" në dosjen rrënjësore të plugin.

Përpiquni të përdorni një format gjerësisht të disponueshëm, pasi hapja e këtij dokumenti varet nga aplikacionet që përdoruesit kanë të instaluara.

SI TË INSTALONI NJË PLUGIN

Instalimi i një plugin-i është i thjeshtë. Mjaton të ndiqni hap pas hapi instruksionet e mëposhtme:

Navigoni në dosjen "ActiveITAuditManual" dhe brenda saj do të gjeni nëndosjen e plugin-eve.



- Kopjoni plugin-in e dosjes kryesore dhe përmbajtjen e kësaj dosje
- Plugin-i është tashmë gati për t'u përdorur

Përdorimi i plugin-eve brenda "ActiveITAuditManual" është gjithashtu i përqendruar në fletë pune Exceli të quajtura "StartHere.xlsm" (kujdes, ju duhet të keni macrot të aktivizuara!).

Sapo të hapni fletën e punës në Excel, ju do të gjeni një faqe të parë të quajtur "**Audit Description**". Kjo i jep përdoruesit mundësinë e ofrimit të një reference të plotë dhe përshkrimit të auditimit, krijimit dhe regjistrimit të informacionit në lidhje me aktivitetet

Udhëzues mbi Manualin Aktiv të Auditimit IT

paraprake dhe fillimin e planifikimit (matricat nën fushat “A1” dhe “A2”), si dhe gjithashtu përdorimit të plugin-eve të instaluar.

Për të nisur me përdorimin e një plugin-i përdoruesi duhet ta zgjedhë atë nga lista e gatshme e kontrolleve në krye të faqes se punës “**Audit Description**”:

Plugins:	<input type="text"/> E-Government & Other Web Services Roll Out Handbook v1 Land Registry Automation Open Data Strategy
Title:	<input type="text" value="Upgrade of Financial Management IT System"/>


Siç mund ta shihni në imazhin e mësipërm, “standard” është një plugin në vetvete në

Shënim:

Nëse keni instaluar një plugin të ri me spreadsheet-in Excel të quajtur “StartHere.xlsm” tashmë të hapur, është e nevojshme të shtypni butonin “Refresh button” për ta listuar atë

Doracakun e Auditimit IT në Institucionet Supreme të Auditimit

Nëse ofrohet, përdoruesi mund të aksesojë përshkrimin e plugin-it duke shtypur butonin “Plugin description”.




Përdoruesi duhet të analizojë informacionin dhe të mendojë të kryejë përshtatje aty ku është e nevojshme

Më pas, ai duhet të zgjedhë butonin “Apply Selected Plugin” për të vazhduar me hapat e mëtejshëm:

- Krijimi i të dhënave specifike të auditimit IT, populluar me fushat dhe çështjet e përshtatura;

Udhëzues mbi Manualin Aktiv të Auditimit IT


- Lidhja me matricat që mundësojnë përcaktimin e aktiviteteve paraprake dhe fillimi i planifikimit (matricat nën fushat “A1” and “A2”) dhe,
- Plotësimi i skedarit “StartHere.xlsm” Brenda plugin-it, titullin dhe fushat e përshkrimit.




Në brendësi, mjeti do të:

- Ndërtojë strukturën e dosjes në rrënjë;
- Kopjojë informacionin specifik në lidhje me fushat e plugin-it, zonat dhe çështjet IT (gjithashtu dhe materiale ndihmëse shtesë)

Ju mund të shihni në imazhin e mëposhtëm shembullin e një auditimi të gjeneruar nga plugin-i, i cili përmban vetëm tre fusha:



Për t'u rikthyer në Doracakun e Auditimit IT në Institucionet Supreme të Auditimit “standard”, zgjidhni plugin-in me titull “Handbook v1” ose më pas dhe klikoni ‘apply’. Përndryshe, ju thjesht mund të klikoni butonin “Revert to Handbook”.



Përshendetje Auditues të IT!